

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Strukture per funizimin e autoboteve me gazoil

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**09134100-8**

VLERA E FONDIT LIMIT:

1'950'000 (njemilion e nenteqind e pesedhjetë mije) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor TERMOCENTRALI-VLORE sh.a , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar,.

- **Argumentimi i AK :** Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Kjo vlerë është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Neni 43 **Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të(*shëno bazën ligjore*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(*Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____ (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese*).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme. Vlera totale e kërkuar duhet të jete ne nje vlere jo me te vogel se 20 % e vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te mesiperme te kontratave te ngjashme te realizuara, e ben oferten te vlefshme

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar,. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ata kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën dhe për të vërtetuar aftësitë tekniko-profesionale të OE me qëllim përmbushjen me sukses të kontrates.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesemarrës në garë, në momentin e zhvillimit të tenderit, të paraqesë në sistemin elektronik të prokurimit dokumentat e mëposhtme:

1. OE të kete në dispozicion inxhier mekanik për ndjekjen e punimeve me të cilin të kete një kontratë pune ose bashkëpunimi, të pakten deri në fund të punimeve.
2. OE të kete në dispozicion saldator me patente për linjat me hidrokarbure dhe enet nën presion, me kontratë pune ose bashkëpunimi, të pakten deri në fund të punimeve.
3. OE të kete në dispozicion specialist për mbrojtje nga zjarri në ambiente me hidrokarbure.
4. OE të kete në dispozicion mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga zjarri gjatë saldimit në park hidrokarburesh me prezencë gazoili.
5. Personeli kryesor që do të kryejë punimet të kete certifikim teknik për mbrojtje nga zjarri, pasi në park janë të magazinuara volume të mëdha të lëndës djegëse (gazoil), dhe punimet do të kryhen në zone me rezikshmeri shumë të lartë.
6. Operatori ekonomik duhet të kete në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e punimeve. Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencas, pjesë e DST

Te gjitha kërkesat e mesipërme, do të paraqiten me vetedeklarim në momentin e tenderimit dhe do të verifikohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,b) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar,

Nepermjet kriterëve të vendosur me sipër nga AK, kërkohet realizimi me sukses i kësaj kontrate dhe përfundimi i saj brenda afatëve të përcaktuara në dst. Kjo procedurë është shumë e rëndësishme në kuadër të venies në punë të di termocentraleve lundruar të ankoruara në gjirin e Vlores dhe fillimit të prodhimit prej tyre të energjisë elektrike.

- **Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë kapacitetet teknike dhe profesionale për ta përfunduar këtë shërbim të rëndësishëm.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike

Specifikimet teknike

1. Tubo 4”

Tubabo celiku me diameter nominal 4”, e perdorshme per gazoil.

Diametri i brensheem $D_b = 100\text{mm}$, diametri i jashtem $D_j = 114.3\text{ mm}$

Gjatesi e cdo cope tuboje standart, afertsisht 6m.

Berberja e materialit te kete veti te mira per saldim dhe qendrushmeri te mire ndaj korodimit.



Pamje per orjentim

2. Fllanxha 4”

Fllanxha celiku 4”, klasi 150. Fllanxhat do jene ne dy skajet e tubacionit per tu bashkuar me tubacioninin e sistemit ekzistues te gazoilit nga njera ane , dhe ne vazhdimesi me elementet e tjere. Fllanxhat te jene te tipit qe bashkohen me saldim me tubacionin.



Pamje per orjentim

3. Bryla 4"

Bryla celiku 4" te kthyer me kend 90⁰ te cilet do te perdoren per bashkimin e tubove aty ku ka kthesa. Brylat duhet te kene veti te mira ne saldim. Te jene i njejti standart me tubot 4" te celikut.



Pamje per orjentim

4. Valvola 4"


Valvol celiku 4" me fllanxhe , per perdorim ne gazoil. Klasi 150 i fllanxhes. Valvol (saracinesk) qe manvrohet (hapje mbyllje) duke rrotulluar volantin. Valvol me fllanxhe per tu bashkuar me bulona.



Pamje per orjentim

5. Valvola 4" me manorim te shpejte

Valvol celiku 4" me fllanxhe , per perdorim ne gazoil. Klasi 150 i fllanxhes. Valvol (me leve) me manovrim (hapje mbyllje) te shpejte. Valvol me fllanxhe per tu bashkuar me bulona.



Pamje per orjentim

6. Valvol moskthimi 4"

Valvol moskthimi celiku 4" me flanaxhe , per perdorim ne gazoil. Klasi 150 i flanaxhes. Valvol moskthimi me flanaxhe per tu bashkuar me bulona.



Pamje per orjentim

7. Kalimates 4"

Kalimatesi per matje te sasise se gazolit per furnizimin e autoboteve. Kalimates me flanaxhe 4", per tu bashkuar ne strukture me bulona. Diapazoni I matjes te perfshije diapazonin 0 – 50 m³/h. Gjate furnizimit te autoboteve fluksi do jete afersisht 30-40 m³/h. Kalimatesi te jete I certifikuar nga IQT.

8. Guarnicione 4"

Guarnicione 4" per hermetizim te gazoilit gjate bashkimeve te flanaxhve. Guarnicioni i klasit per gazoil.



Pamje per orjentim

9. Valvol 3/4"

Valvol celiku 3/4" me flanaxhe , per perdorim ne gazoil. Valvol (saracinesk) qe manvrohet (hapje mbyllje) duke rrotulluar volantin. Valvol me flanaxhe per tu bashkuar me bulona. Valvolat do te perdoren per drenazhim/cajrim te tubacionit.



Pamje per orjentim

10. Tubo gome

Tubo gome fleksibel 3” me kapje te shpejte ne te dyja anet. Nga nje ane do te bashkohet me strukturen te cilat duhet te kete dalje qe pershtaten me njera tjetren. Tubo goma ne anen tjetër daljen ta kete per tu bashkuar me autobotin.



Pamje per orjentim

11. Profil dopjo T


Profil celiku dopjo T I cili do te sherbej si suport per mbajtjen e sigurte te cdo pjese te struktures.



Pamje per orjentim

Me kete profil do te pergatiten suportte qe te pershtaten ne pamje me strukturen ekzistuese te gazoililit. Edhe ngjyra e bojës do te pershtatet me ate te suporteve ekzistues. Profilet jane dy tipesh.

Nje tip profili 12m gjatesi, eshte 160 x 160 mm , ndersa pjesa tjetër 24m gjatesi eshte 100 x 100 mm



Pamje per orientim te formes se suporteve qe do te behen



Pamje per orientim e kapeseve per fiksimin e tubacinit ne suport.

Shenim i rendesishem: Kudo ku ka nje emer apo marke eshte edhe termi ekuivalent. Pamjet jane vetem per orientim.

TERMAT E REFERENCES

- Autoriteti Kontraktor do te sugjeroje skemen zbatuese per berjen e struktures, idene e pershtatjes me strukturen ekzistuese, ne menyre qe kjo strukture te plotesoje kriteret si te sigurise po ashtu edhe te funksionalitetit. Operatori Ekonomik do te jape sugjerimet e tij te cilat do tja paraqese grupit te ndjekjes se zbatimit te kontrates (perfaqesues te TEC Vlore) per te konkluduar ne skemen zbatuese me optimale.

Sugjerim ne skemen zbatuese do te thote:

- a). Vendorsja dhe pozicionimi i cdo pjese; flanaxhe, valvol, valvol moskthimi etj.
 - b). Menyra e vendosjes, pozicionimit, mbeshtetjes dhe fiksimit te tubacionit 4" ne te gjitha gjatesine e tije.
- Vetem pas aprovimit te planit te zbatimi nga grupi i ndjekjes dhe zbatimit te kontrates, operatori ekonomik ka te drejte te filloje nga puna. Edhe gjate zbatimit te punimeve, grupi i ndjekjes se zbatimit te kontrates ka te drejte te nderprese punimet nese punimet nuk jane me cilesi apo materialet qe perdoren nuk jane te duhurat .
 - Te gjitha punimet do te behen vetem kur te jene marre masat e duhura teknike dhe te sigurise nga operatori ekonomik.
 - Personeli kryesor qe do te kryeje punimet te kete certifikim teknik per mbrojtje nga zjarri, pasi ne park jane te magazinuara volume te medha te lendes djegese (gazoil), dhe punimet do te kryhen ne zone me rezikshmeri shume te larte.
 - Ne hyrje te kalimatesit te vendoset filter
 - Ne perfundim te procesit te pastrimit do te behet testim hidraulik i struktures per rjedhje.
 - Operatori ekonomik eshte i detyruar te zbatoje te gjitha proçedurat e operimit, mirembajtjes dhe sigurise te impiantit.
 - Ne perfundim te punimeve operatori ekonomik do te beje pastrim te pjeses se brendshme ne gjithë gjatesise se linjes nga papastertite qe mund te kene mbetur gjate procedures se punimeve.

Argumentimi : Te gjitha kerkesat e mesiperme ne termat e references, jane kerkuar nga AK per rendesine dhe vecantine qe ka ky sherbim, dhe per faktin se do te punohet ne struktura te rrezikshme per shkak te punimeve qe do te kryhen dhe ambjentit ku do te kryhet ky sherbim.

I gjithë sherbimi i kerkuar do te perfundoje brenda 20 diteve nga nenshkrimi i kontrates midis paleve